



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Legjislatura e III-të

Nr. 20/09

Prishtinë, më 7.04.2009, ora 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

nga mbledhja e Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Anëtarët e pranishëm të Komisionit: **Bojan Stojanović, Sanije Aliaj, Hafize Hajdini, Kosara Nikolić, Müfera Şinik, Enis Kervan, Zylfi Merxha, Hetem Arifi, Zafir Berisha, Sadik Idriz, Mursejl Haljilji.**

Anëtarët jo të pranishëm të Komisionit: **Numan Balić, Xhevdet Neziraj.**

Gjithashtu të pranishëm ishin: moniturores nga KDI, OSCE.

Nga shërbimi i sekretarisë: **Natasha Prica-Tisma, Vilson Ukaj, Dashurije Canolli.**

Kryesues: Bojan Stojanović, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar dt. 17.03.2009;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për Protokollin e Shtetit të Republikës së Kosovës nr. 03/ L-132 me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Punë të Jashtme, me amendamente;
4. Shqyrtimi i Projektligjit për zonat ekonomike nr. 03/L-129 me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Ekonomi, Industri, Tregti, Energjetikë dhe Telekomunikacion, me amendamente;
5. Shqyrtimi i Projektligjit për produktet Biocide nr. 03/ L-119 me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Bujqësi, Pylltari , Zhvillim rural , Mjedis she Planifikim Hapësinor, me amendamente;
6. Të ndryshme.

Kryesuesi, hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendit i ditës miratohet pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar dt. 17 mars 2009

Kryesuesi, konstatoi se procesverbali nga mbledhja e dt. 17 mars 2009, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Protokollin e Shtetit të Republikës së Kosovës nr. 03/L-132 me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Punë të Jashtme, me amendamente

Kryesuesi, kërkoi nga anëtarët të deklarohen lidhur me projektligjin në fjalë dhe amendamentet e propozuara, nëse mendojnë se ato cenojnë apo shkelin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Enis Kervan, si anëtar i komisionit funksional, theksoi se në amendamentin 41 ka pasur dy propozime për plotësimin e tij, të cilat nuk janë marrë parasysh. Në grupin e dytë të radhitjes së rangjeve zyrtare ka propozuar që pas kryetarëve të komisioneve të jenë edhe zëvendëskryetarët e komisioneve parlamentare. Ndërsa propozimi i dytë po ashtu ka të bëjë me grupin e dytë që pas kryetarëve të komunave të përfshihen edhe zëvendëskryetarët e komunave. Duke pasur parasysh faktin se në këto pozita përfaqësohen edhe komunitetet jo shumicë, kërkoi që komisioni të mbështeti propozimet e tij për plotësimin e këtij neni.

Sadik Idriz, mbështeti propozimin e parë të z. Kervan për përfshirjen e zëvendëskryetarëve të komisioneve, ndërsa mospërfshirja e nënkryetarëve të komunave theksoi se mund edhe mos të jetë problematike. Në vazhdim propozoi që në grupin e dytë të përfshihen edhe zëvendësministrat.

Sanije Aliaj, përkrahu propozimet që në rangjet zyrtare të përfshihen zëvendëskryetarët e komunave, zëvendësministrat dhe zëvendëskryetarët e komisioneve parlamentare. Përfshirja e zëvendëskryetarëve të komisioneve parlamentare të bëhet për shkak të përgjegjësiive që kanë ata në përfaqësimi e komisionit, në rastin e mungesës së kryetarëve të komisioneve.

Kryesuesi, mbështeti propozimet që në listën e rangjeve zyrtare të përfshihen edhe zëvendësministrat, zëvendëskryetarët e komisioneve parlamentare dhe zëvendëskryetarët e komunave, në këtë mënyrë do të përfaqësoheshin edhe të drejtat e komuniteteve kur dihet se disa nga këto pozita i udhëheqin ata.. Prandaj kërkoi që të paraqesin një amendament për plotësimin e nenit 36, respektivisht të listës së rangjeve zyrtare në nivele protokollare shtetërore.

Pasi vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se dhjetë vota Për, një Abstenim dhe asnjë Kundër, Komisioni nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I.** Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin për Protokollin e Shtetit të Republikës së Kosovës nr.03/L-132 dhe ka konstatuar se dispozitat e tij nuk cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

- II. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Punë të Jashtme dhe ka konstatuar se amendamentet nuk cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Vërejtje konkrete

Amendamenti 1

Amendamenti 41 që i referohet nenit 36 të projektligjit, të plotësohet si në vijim:

Në grupin e II, pas shprehjes “Ministrat e Qeverisë sipas listës së dekretimit”, shtohet ”Zëvendësministrat e Qeverisë”, dhe pas shprehjes “Kryetarët e Komisioneve Parlamentare”, shtohet “Zëvendëskryetarët e Komisioneve Parlamentare”.

Në grupin e III, pas shprehjes “Kryetarët e Komunave”, shtohet shprehja “Zëvendëskryetarët e Komunave”.

Arsyetim:

Komisioni ka konstatuar se amendamentet e propozuar kanë për qëllim respektimin e të drejtave të të gjitha komuniteteve me rastin e përparësisë së rangjeve zyrtare në nivelin e Protokollit të Shtetit të Republikës së Kosovës.

- III. Komisioni rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për zonat ekonomike nr. 03/L–129 me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Ekonomi, Industri, Tregti, Energjetikë dhe Telekomunikacion, me amendamente

Kryesuesi, kërkoi nga anëtarët të deklarohen lidhur me projektligjin në fjalë dhe amendamentet e propozuara, nëse mendojnë se ato cenojnë apo shkelin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Pasi që nuk kishte vërejtje, Kryesuesi konstatoi se dhjetë vota Për, një Abstenim dhe asnjë Kundër, Komisioni nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin për zonat ekonomike dhe ka konstatuar se dispozitat e tij nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Ekonomi, Industri, Tregti, Energjetikë dhe Telekomunikacion dhe ka konstatuar se amendamentet nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

5. Shqyrtimi i Projektligjit për produktet Biocide nr. 03/ L-119 me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Bujqësi, Pylltari , Zhvillim rural , Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, me amendamente

Kryesuesi, kërkoi nga anëtarët të deklarohen lidhur me projektligjin në fjalë dhe amendamentet e propozuara, nëse mendojnë se ato cenojnë apo shkelin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Pasi që nuk kishte vërejtje, Kryesuesi konstatoi se, Komisioni njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin për produktet Biocide nr. 03/ L-119 dhe ka konstatuar se dispozitat e tij nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Bujqësi, Pylltari , Zhvillim rural , Mjedis dhe Planifikim Hapësinor dhe ka konstatuar se amendamentet nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

6. Të ndryshme

Kryesuesi, njoftoi se ka ftuar personin për të biseduar lidhur me organizimin e tryezës së rumbullakët, por për shkaqe shëndetësore nuk ka mundur të jetë i pranishëm. Ndërsa lidhur me udhëtimin në Zvicër theksoi se është në kontakt me personat përgjegjës. Një tjetër çështje që përmendi ishte çështja e problemeve që ekzistojnë në zyrën për deputetë në Graçanicë, dhe theksoi se si komision do të japim rekomandimet dhe do të kërkojmë zbatimin e ligjit.

Müfera Şinik, njoftoi për moszbatimin e ligjit për letërnjoftimin në komunën e Prizrenit. Përmendi rastin e fundit kur ajo ka marrë një certifikatë të lindjes me shtetësinë e Kosovës në të cilën nuk figuron gjuha turke, e që dokumentet civile të lëshuara më herët nga UNMIK-u ka figuruar. Prandaj kërkoj nga komisioni të reagoj që të respektohet ligji për gjuhët zyrtare.

Kryesuesi, propozoi që të ftohet Komisioni për Siguri dhe Punë të Brendshme për të marrë informacione rreth zbatimit të ligjit për gjuhët zyrtare.

Sanije Aliaj, duke u ndërlidhur theksoi se ne kemi marrur qëndrimin si komision drejtuar institucioneve përkatëse për zbatimin ligjit. Prandaj të kërkojmë takim me Ministrin e Punëve të Brendshme dhe Ministrin e Shërbimeve Publike për të diskutuar për këto çështje. Ndër të tjera Znj. Aliaj njoftoi se ka pasur takim me përfaqësuesit e ambasadës Zviceriane në Shkup të cilët kanë shprehur dëshirën për pjesëmarrje në mbledhjet e komisionit. Përveç kësaj Znj. Aliaj njoftoi se nga takimi që është zhvilluar në mes kryeparlamentarit me kryetarët e komisioneve parlamentare është kërkuar nga komisioni për komunitete të procedoj Projektligjin për shitjen e banesave në mbledhjen e radhës. Plani i veprimtimit i miratuar ka paraparë disa objektiva edhe për komision tonë, andaj kërkoj që të punohet në realizimin e tyre.

Kryesuesi, lidhur me projektligjin për shitjen e banesave, theksoi se do të jepet edhe pak kohë ICO dhe pastaj do të radhitet në mbledhjen e komisionit i cili do të iu nënshtrohet votimit. Ndërsa për përcjelljen e mbledhjes nga të interesuarit theksoi se ftesa është e pranuar. Lidhur me propozimin për ftesën e komisionit për siguri, theksoi se mund të ftohet edhe komisioni, por edhe ministritë përkatëse.

Mbledhja përfundoi në ora 14:00

Përgatitur nga
Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryesuesi i Komisionit,

Bojan STOJANOVIĆ